Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në nenet 37 dhe 38 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2012-MPB për Themelimin, Përbërjen dhe Procedurat e Komisionit për Emërime të Larta në Polici, shpall:

K O N K U R S

Titulli i pozitës: Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Referenca: MPB-DP/PK

Numri i pozitave: Një (1)

Vendi i punës: Prishtinë

Kohëzgjatja e mandatit: Pesë (5) vjet, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjetësh nga autoriteti që e ka emëruar, në përputhje me Ligjin për Policinë.

Orari i punës: I plotë

Paga: Sipas ligjit në fuqi për pagat në sektorin publik.

Përgjegjësi për menaxhim ekzekutiv: Po

Raportimi: Drejtori i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit të Punëve të Brendshme për administrimin dhe menaxhimin e Policisë së Kosovës, në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Policinë.

1. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- Udhëheq, kontrollon dhe mbikëqyr Policinë e Kosovës dhe është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e saj.
- Menaxhon dhe shpërndan buxhetin e Policisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektivat e qëllimet strategjike të përcaktuara nga Ministri i Punëve të Brendshme.

- Siguron zbatimin e politikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme që kanë të bëjnë me Policinë, brenda kompetencave dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj.
- Propozon strukturën e brendshme organizative të Policisë për miratim nga ministri.
- Me miratimin e ministrit, themelon njësi policore të përkohshme për kryerjen e detyrave të veçanta, sipas ligjit.
- Bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata, raporte dhe këshilla profesionale për çështjet që lidhen me administrimin, menaxhimin dhe funksionimin e Policisë.
- Siguron që ushtrimi i detyrave dhe autorizimeve policore të bëhet në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, paanshmërinë, integritetin dhe përgjegjshmërinë.
- Zbaton parimet e meritës, mosdiskriminimit, barazisë gjinore dhe përfaqësimit shumetnik në menaxhimin e personelit të Policisë.
- Kryen detyrat e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Kushtet ligjore për përzgjedhje dhe emërim

Kandidati/ja duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 38 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë:

- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës.
- Të jetë i/e diplomuar në një nga universitetet e akredituara në Kosovë ose të ketë diplomë të fituar jashtë vendit dhe të nostrifikuar.
- Të ketë gradën policore kolonel, nënkolonel ose major, së paku pesë (5) vjet.
- Të mos ketë qenë i/e dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë.
- Të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore sipas rregullores disiplinore të Policisë apo rregullores së institucioneve të tjera shtetërore brenda dhjetë (10) vjetëve të fundit, që janë ekuivalente me shkeljet e përcaktuara në rregulloren e disiplinës së Policisë së Kosovës.
- Të mos ketë konflikt interesi me detyrën, sipas legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Secili kandidat për këtë pozitë duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë, sipas nenit 38, paragrafit 2, të Ligjit për Policinë dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Komisioni për Emërime të Larta në Polici kujdeset për këtë proces në përputhje me nenin 13, paragrafin 10, të Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2012-MPB.

Secili kandidat duhet të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

3. Aftësitë dhe kompetencat profesionale që vlerësohen

Gjatë vlerësimit profesional të kandidatëve, vlerësohen këto aftësi dhe kompetena:

- Aftësitë për udhëheqje strategjike, planifikim dhe zbatim të objektivave institucionale.

- Aftësitë për menaxhimin e personelit, buxhetit dhe burimeve të tjera institucionale.
- Aftësitë për koordinim, mbikëqyrje dhe kontroll të zbatimit të detyrave.
- Aftësitë për vendimmarrje dhe menaxhim në situata komplekse dhe nën presion.
- Aftësitë për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe vlerësimin e rezultateve të punës.
- Aftësitë për komunikim të qartë me shkrim dhe me gojë, negocim dhe bashkëpunim institucional.
- Integriteti profesional, paanshmëria dhe përkushtimi ndaj zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

4. Dokumentet e nevojshme për aplikim

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar dhe i nënshkruar.
- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës.
- Kopja e diplomës universitare ndërsa për diploma të fituara jashtë vendit edhe vendimi për nostrifikimin e saj.
- Dëshmia nga njësia përkatëse në Polici për gradën policore dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së saj, për vërtetimin e plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 38, nënparagrafin 1.3, të Ligjit për Policinë. Dëshmia duhet të përmbajë gradën ose gradat e mbajtura dhe datat përkatëse.
- Certifikata nga evidenca penale, e lëshuar nga organi kompetent, që dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë i/e dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë.
- Dëshmia nga institucioni kompetent për mungesën e ndëshkimit për shkelje të rënda disiplinore gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit, sipas kushtit të përcaktuar në këtë konkurs.
- Deklarata e nënshkruar se kandidati/ja nuk ka konflikt interesi me ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
- Jetëshkrimi (CV).
- Letra e motivimit, në të cilën paraqiten arsyet e kandidimit dhe përvoja përkatëse për ushtrimin e kësaj detyre.

Kandidatët që posedojnë certifikatë të vlefshme të sigurisë duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit një kopje të saj.

Kandidatët e ftuar në intervistë duhet t'i paraqesin për verifikim dokumentet origjinale, kopjet e të cilave i kanë dorëzuar gjatë aplikimit.

5. Mënyra e aplikimit

Formulari i aplikimit mund të merret në recepcionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme ose të shkarkohet nga faqja zyrtare e Ministrisë, në të cilën publikohet konkursi.

Aplikacioni dhe dokumentacioni përcjellës dorëzohen në njërën nga këto mënyra:

- **Fizikisht:** në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MPB, rr. "Luan Haradinaj", p.n., Prishtinë, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në orën 16:00.
- **Përmes postës:** në adresën e rr. "Luan Haradinaj", p.n., Prishtinë, me shënimin "*Aplikim për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës – Referenca MPB-DP/PK*".
- **Përmes postës elektronike:** në adresën ahmet.sh.gashi@rks-gov.net me të njëjtin dhe me dokumentacionin e skanuar, të plotë e të lexueshëm.

Në formularin e aplikimit duhet të shënohen saktë numri i telefonit dhe adresa elektronike për komunikim me kandidatin/en.

6. Afati për aplikim

Data e hapjes së konkursit: 05.11.2026.
Data e mbylljes së konkursit: 19.11.2026, në orën 16:00.

Aplikacionet e paraqitura pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në këtë konkurs. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

7. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve, përzgjedhja për intervistë dhe intervistimi kryhen nga Komisioni për Emërime të Larta në Polici.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs ftohen në intervistë. Kandidatët njoftohen me kohë për datën, orën dhe vendin e intervistimit, përmes kontakteve të deklaruara në aplikacion.

8. Informata shtesë

Për informata dhe sqarime lidhur me konkursin, kandidatët mund të kontaktojnë:

Personi kontaktues: Ahmet Gashi, ud Udhëheqës i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerezore në MPB.
Adresa: Ministria e Punëve të Brendshme, rr. "Luan Haradinaj", p.n., Prishtinë
Telefoni: 038 200 76 627
Posta elektronike: ahmet.sh.gashi@rks-gov.net

Ministria e Punëve të Brendshme siguron mundësi të barabarta dhe trajtim pa diskriminim gjatë procedurës së konkurrimit. Inkurajohen të aplikojnë gratë dhe burrat nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs.